

**AKTI I THEMELIMIT I  
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“Flex”**

Sot, ne Tirane, me daten 01.11.2023, z. Arlind Kuka, mblidhet, diskuton dhe vendos sa vijon:

**NENI 1**

Krijohet shoqeria **Flex sh.p.k.**

Nga ortaku themelues: **Arlind Kuka**.

Emertimi i shoqerise do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

**NENI 2**

Selia zyrtare e shoqerise do te jete ne: Yrshek, Tirane.

**NENI 3**

Kapitali i nenshkruar i shoqerise eshte 100,000 (Njeqind mijë) leke i ndare ne 1 kuote.

**NENI 4**

Kuotat e kapitalit te Shoqerise zoterohen nga ortaket si me poshte:

Z. Arlind Kuka, zoteron 1 (nje) kuote me vlere 100,000 leke ose 100% te kapitalit.

Asambleja e per gjithshme mund te rrise pa kufi kapitalin e shoqerise. Rritja e kapitalit mund te behet nepermjet financimoit te ortakeve ose nepermjet perfshirjes ne kapital te fitimeve dhe rezervave te shoqerise.

Kuotat e kapitalit mund t'u transferohen te treteve teresisht ose pjeserisht, vetem me vendim te asamblese se per gjithshme bazuar ne dispozitat e legjisacionit te aplikuar dhe parashikimeve te Statusit te Shoqerise.

## **NENI 5**

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar.

## **NENI 6**

Shoqeria zhvillon aktivitetin tregtar ne perputhje te plote me Legjislacionin Shqipetar ne fuqi, bazuar ne Ligjin nr.9901, date 14.04.2008, “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare” si dhe bazuar ne kete Akt Themelimi dhe Statutin e saj.

## **NENI 7**

Shoqeria hap llogari bankare ne monedhe shqiptare dhe ne cdo valute tjeter ne banka vendase ose te huaja, private apo shteterore me qellim ushtrimin e aktivitetit te saj.

## **NENI 8**

Ortaket kane te drejte te transferojne jashte territorit te Republikes se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e tyre perfshire fondet dhe kontributet e pjeseve te kapitalit themelor. Transferimet duhet te jene te vertetuara me Akt Notarial dhe duhet te merret paraprakisht vendimi me shkrim i Asamblese se Ortakeve. Shoqeria dhe te tretet duhet te respektojne keto transferime apo te behen te ditura.

## **NENI 9**

Aktiviteti i shoqerise do te jete:

Shitje me pakice te materialeve te dekorit, pajisjeve te ndricimit, artikujve shtepiake dhe mobiljeve si dhe cdo aktivitet tjeter tregtar te lejuar me ligj.

## **NENI 10**

Me vendim te Asamblese se Ortakeve, shoqeria mund te zgjeroje aktivitetin e saj tregtar dhe ne drejtime te tjera te cilat jane me interes per shoqerine.

### **NENI 11**

Me vendim te Asamblese se Ortakeve, shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere, shtetas shqiptare ose te huaj, ose te bashkohet me nje shoqeri tregtare tjeter si brenda dhe jashte vendit.

### **NENI 12**

Organi me i larte drejtues i Shoqerise eshte Asamblea e Pergjithshme e Ortakeve, e cila eshte perjegjese per vendimet e shoqerise duke ushtruar kompetencat bazuar ne ligjin “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare”.

Ortaket mund ti delegojne kompetencat nje ose me shume administratoreve te caktuar prej tyre ose nje person fizik jashte ortakerise se shoqerise, bazuar mbi nje prokure.

### **NENI 13**

Duke filluar nga data e miratimit te statusit dhe aktit te themelimit, administratori i shoqerise “Clever Lynx Albania” shpk per nje periudhe 5-vjeçare do te jetë:

Z. Arlind Kuka

Administratori i shoqerise gezon te gjithe te drejtat qe ligji “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare” parashikon pa asnje kufizim te kompetencave. Asambleja e pergjithshme mund te emeroje dhe shkarkoje administratorin ne çdo kohe, me shumice te zakonshme.

Ky akt themelimi u redaktua ne dy kopje ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejtë juridike dhe eshte i vlefshem kur nenshkuhet nga ortaket themelues.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

**ARLIND KUKA**

*Arlind Kuka*  


Tirane, me 01.11.2023